



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

Komiteti për Komunitete

01Nr. 06-51725 2019

Klinë, 11. 01. 2019

30.12.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-ë e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë 11. 01. 2019, në sallën për mbledhje në Komunën e Klinës, nisur nga ora 13:00.

Kryesuesi, Z. Enver Gashi, pasi konstaton se pjesëmarrja e anëtarëve të Komitetit është e mjaftueshme për të mbajtur mbledhjen, ai, falënderon për prezencë përfaqësuesit e UNMIK, KFOR, USAID, OSBE, OJQ "Koha", zyrën për Komunitete dhe Kthim. Dhe fillon mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete në vitin 2019, me rendin e ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit të mbledhjes së fundit

2. Informim rreth procesit mësimor të komunitetit RAE, numrin e tyre në shkolla, numrin e nxënësve lidhur me marrjen e bursave të komunitetit RAE. (Ref. Drejtoria e Arsimit)

3. Informim rreth menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Klinës (Ref. Drejtoria e Shërbimeve Publike)

4. Të ndryshme

Pas ndërhyrjes së anëtares së Komitetit znj. Mire Rama, në lidhje me një gabim teknik në shkurtesën RAI e që duhet të ishte RAE, me vota unanim aprovohet Rendi i Ditës, dhe kryesuesi z. Gashi, kalon në pikën e parë të Rendit të Ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, i cili procesverbal aprovohet nga anëtarët e komitetit, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim. Në vazhdim kryesuesi, Gashi shpjegon se në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, në të cilën pikë është dashur që të jep informacionet e kërkuara DKA, nuk mund të ndalen pasi që përfaqësuesit kompetent nga DKA janë në teren dhe nuk kanë pasur mundësi të jenë prezent në mbledhje. Sipas Kryesuesit, përfaqësuesit e DKA në Klinë kanë premtuar se do të marrin pjesë në mbledhjen e ardhshme të Komitetit dhe do të raportojnë sipas kërkesës së Komitetit. Gjithashtu edhe pikën e tretë të rendit të Ditës nuk mund ta diskutojnë pasi që mungonte përfaqësuesi nga Drejtoria për Shërbime Publike. Kryesuesi Gashi, shprehu shqetësimin e tij dhe të Komitetit për mos pjesëmarrjen për tre herë radhazi të përfaqësuesit nga kjo drejtori dhe si rrjedhojë pika e rendit të ditës "Informim rreth menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Klinës", e caktuar tre herë radhazi nuk është arrit të realizohet. Z. Gashi, thekson se për mos

pjesëmarrjen e tij, drejtori i shërbimeve publike nuk e ka njoftuar asnjëherë, as me shkrim dhe në asnjë formë tjetër. Në mungesë të përfaqësueseve nga dy drejtoritë me të cilat lidheshin dy pikat e Rendit të Ditës, kryesuesi, z. Enver Gashi, kalon në pikën e fundit të Rendit të Ditës, në "Të ndryshme", dhe i fton anëtarët e Komitetit që të marrin fjalën.

Znj. Silvija Raskovic: Ju faleminderit kryesues. Falënderoi përfaqësuesit e KFOR, OSBE, USAID, "KOHA", UNMIK, për kohën e shpenzuar në këtë takim dhe për gatishmërinë e tyre për pjesëmarrje. Në mbledhjen e kaluar nuk ka qenë kjo përbërje, prandaj sot më gëzon prezenca e juaj. Nuk kam për të thënë as unë ndonjë gjë të veçantë. Në takimin e fundit kam raportuar se çfarë kemi punuar si zyre e Komunitetit, ky është tani vetëm fillimi i vitit dhe do të nisim me aktivitete të ndryshme. Në këtë takim kemi përfaqësuesin e USAID nga projekti LEGO, z. Naser Hashimi, e kam përmendur në takimin e fundit, se kemi ndërtuar pesë shtëpi, mendoj se ka qenë e shkruar në raport. Ato pesë shtëpi, javën e ardhshme do të furnizohen me inventar dhe ushqime. Do të kemi takime të tjera dhe informacionet do ti japim kurdo që të zhvillohen aktivitete. Sa i përket komunitetit RAE, na mungon Agimi për të na dhënë informacione, ndoshta Nexhmedini më vonë kryqet dhe na informon. Ju falënderoi përsëri.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje përfaqësues nga të gjitha organizatat, prezent në këtë takim. Ne edhe në mbledhjen e fundit kemi kërkuar që ta dimë numrin e të kthyerve në Komunë e Klinës, sa shtëpi janë ndërtuar për të kthyerit dhe sa nga ato shtëpi janë të banuara?

Znj. Silvija Raskovic: E kam këtë numër dhe do të jua jap tani. Numri i shtëpive të ndërtuara sipas projekteve të ndryshme, në total është 449 shtëpi. Numri i të kthyerve sipas projektit është 1288 individ të kthyer. Ndërsa gjendja reale në teren, shtëpitë e ndërtuara dhe që janë të banuara është 129 shtëpi. Numri i të kthyerve që jetojnë këtu, lëviz nga 206 deri në 233.

(zotëria nuk prezantohet) UNMIK: kam një pyetje për ju. Kur thoni numri i shtëpive të ndërtuara sipas projekteve për të kthyerit, për cilin vit bëhet fjalë? Kur flasim për të kthyerit, a po flasim vetëm për bashkësinë serbe?

Znj. Silvija Raskovic: Nga viti 2002 deri sot. Jo, kur flasim për të kthyerit, flasim për të gjitha komunitetet, serbet dhe komuniteti RAE. Gjithashtu flasim për të kthyerit nga gjithandej vendeve jashtë Kosovës; Serbisë, Malit të zi etj.

z. Enver Gashi, kryesues: Kam edhe unë një problem për ta theksuar. Suzana Smigic, anëtare e Komitetit, është duke munguar vazhdimisht. Ju e dini që mungesa e anëtarit tre herë radhazi pa dhënë arsyen, duhet të procedohet rregullorja- d.m.th. zëvendësimi i tij-saj.

Znj. Silvija Raskovic: Këtë problem e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar. Dhe kemi thënë që nëse nuk vjen edhe në këtë takim e sotëm, atëherë kemi mundësi që ta zëvendësojmë. Nga ky takim ne do të propozojmë të zëvendësohet me një anëtar tjetër, dhe në takimin e ardhshëm të jetë prezent anëtar i ri.

z. Enver Gashi: Faleminderit. Atëherë na dërgoni emrin e ri, në mënyrë që ne të kemi mundësi të bëjmë kërkesën për zëvendësim në Kuvend.

z. Naser Hashimi: Jam këshilltar regjional i Qeverisjes lokale. Deshiroj të ju informoi për projektin e ri dhe partneritetin me Komunën e Klinës. Ky është një Project i ri, i financuar nga USAID. Edhe Komuna e Klinës sikurse 13 Komuna të tjera është përzgjedhur si Komunë Partnere. Pra janë 14 Komuna Partnere

në këtë projekt. Komuna e Klinës ka qenë edhe më herët partnere shumë konstruktive me USAID, sidomos duhet veçuar projektin e fundit që e kemi pasur në partneritet me Klinën, projektin :Ta avancojmë Kosovën, 2014-2016. Tani në këtë projekt, ne, kemi objektivat tona. Kemi planin e veprimit që ende nuk është aprovuar. Duam që ti identifikojmë nevojat e Komunave dhe të organizojmë aktivitete. Kemi kornizat dhe objektivat. Objektivi i parë është që të bëjmë funksionalizimin e plotë të Komunave partnere në aspektin e ofrimit të shërbimeve të qytetarëve. Pra, funksionalizimin e Administratës. Objektivi i dytë ka të bëjë me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim marrje. Në kuadër të këtyre dy objektiveve, ne kemi biseduar edhe me ekzekutivin dhe Kuvendin dhe do të përkrahim, lehtësojmë, funksionalizimin e plotë edhe të Komitetit tuaj. Qëllimi i USAID më këtë projekt është rritja e pjesëmarrjes së Komunitetit në procesin e vendim marrjes. Mendoj që do të kemi bashkëpunimin e mirë, dhe çfarë varet nga projekti në kuadër të kornizave në bashkëpunim me menaxhmentin-ekzekutivin por edhe me përfaqësuesit e legjislacionit, do të mundohemi që të ndihmojmë. Këto dy muajt e fundit kemi bashkëpunim të shkëlqyer me zyrën për kthim, znj. Silvija. Në këtë aspekt pata një pyetje sa i përket planit të punës së këtij Komiteti për vitin 2019. A e keni hartuar dhe a është aprovuar?

z. Enver Gashi, kryesues: Faleminderit Naser. Jo akoma nuk e kemi punuar planin e punës për vitin 2019, por së shpejti do ta kemi.

z. Naser Hashimi, përfaqësues i USAID: Në disa komuna të tjera, komiteti për Komunitete , ka formuar një grup punues për hartimin e planit të punës dhe kanë arritur që ta bëjnë gati një draft. Kemi bashkëpunim me Komunitet e tjera që e kanë hartuar planin e punës, nëse keni nevojë për shkëmbim të përvojave, mund ta lehtësojmë. Ne mendojmë që në kuadër të këtij projekti, Komiteti për Komunitete duhet të funksionalizohet në plotësi dhe prandaj jemi këtu që të ndihmojmë. Do të kemi kontakte me kryesuesin e Komitetit dhe me anëtarët e tjerë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre.

Znj. Silvija Raskovic: mendoj që të bisedojmë për Rendin e Ditës për takimin e ardhshëm.

z. Haxhi Thaçi, përfaqësuesi i OSBE: Është më rendësi kjo ndihmë që po ju ofrohet nga kolegu. Me siguri ka ndonjë plan model nga Komunitet e tjera dhe të mos harxhohet shumë energji. Këtë model të planit të punës e ndryshoni sipas specifikave që janë në Komunitetin tuaj.

z. Naser Hashimi përfaqësues i USAID: Kohëzgjatja e këtij projekti është 5 vjeçare. Ne do t'ju mbështesim gjatë kësaj kohe në arritjen e objektivave. Planet e punës nga Komunitet e tjera mund ti sigurojmë gjithsesi. Sa i përket grupit punues tuajin, dua të theksoj se na duhen grupe punuese aktive dhe jo vetëm në letër. Është sugjerim i imi që në kuadër të grupit punues dhe në kuadër të kornizave dhe praktikave të mira ligjore, të zgjidhni një grup punues që sa më parë të filloj punën. Vet procesi i përpilimit të planit të punës është një lloj ngritje e kapaciteteve.

z. Enver Gashi, kryesues: A mund të na tregoni se cila Komune e ka hartuar këtë plan të punës?

Në këtë pyetje të kryesuesit, përgjigjet përfaqësuesi i USAID i cili thekson se është Komuna e Obiliqit e cila ka hartuar planin e punës së Komitetit për Komunitete. Më pastaj fillon një bashkëbisedë në formë Interaktive dhe pa prezantime të folësve.

Znj. Mire Ramaj: Unë kam qenë edhe në mandatin e kaluar anëtare e këtij Komiteti dhe ajo që po më shqetëson është se edhe këtë mandat, sikurse edhe në të kaluarën, prej që jemi formuar si Komitet, të

njëjtat pika të Rendit të Ditës jemi duke i zhvilluar. Do të dëshiroja që të jemi pjesë e takimeve gjatë hartimit të planit të punës së Komitetit.

z. Valmir Bacaj: Dëshiroi me u ndërlidhë pak tek Plani i Punës. Ne mund ta marrim si kornizë a model planin e punës nga një Komune tjetër por jo "copy-past" sepse Komuna ka specifikat e veta.

z. Enver Gashi, kryesues: Në lidhje me atë që e theksoi znj. Rama, rreth Rendit të Ditës që po përsëritet. Dua të theksoi se vërtetë që po përsëritën disa pika të Rendit të Ditës sepse po mungojnë personat zyrtar që do të raportonin për atë pikë të Rendit të Ditës, por kjo nuk ja ndalon zonjës Rama që të propozoi pika të reja dhe të ndryshme nga këto që të futen në Rend Dite, gjë që nuk e ka bërë deri me tani. Cilido nga anëtarët e Komitetit që propozon një pikë të rendit të ditës, unë në konsultim me zyrën për komunitete dhe kthim, e fus në rend dite gjithsesi.

Pasi që kryesuesi i Komitetit, Enver Gashi, konstaton se u shtjerr debati për pikën e fundit të rendit të ditës, ai duke i falënderuar të gjithë për prezencën e tyre e mbyllë mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtës

Skënder Behramaj



Kryesuesi

Enver Gashi